



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:102025

Datë: 24.02.2020

Numri i dokumentit: 00850159

P.nr.1/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË DRAGASH, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Kujtesa Uka, në lenden penale kundër të akuzuarit M.S, nga fshati ..., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.1 e lidhur me nenin 1 par.1 të KP-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.139/2015 të datës 18.08.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Naim Gashi, të akuzuarit, mbrojtësit të akuzuarit, avokat S.B, të dëmtuarit L.K dhe përfaqësuesit të tij sipas autorizimit zëvendësues avokat V.K, nga përfaqësuesi i të dëmtuarit sipas autorizimit avokat R.K, me datë 27.01.2020, morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M.S, nga i ati I.dhe nëna F. e lindur D., i lindur me datë ..., në fshatin ..., komuna e ..., ku edhe jeton, ka të kryer fakultetin juridik, avokat, i martuar, baba i ... fëmijëve, goran, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Prej datës 11.06.2014 e deri me datë 26.06.2014 në Dragash, i pandehuri gjatë përfaqësimit për interesa pasurore si përfaqësues në cilësinë e avokatit i të paditurit – në këtë rast të dëmtuarit L.K, nuk i përmbush obligimet dhe detyrimet e tij sipas autorizimit, nuk paraqet ankesë kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Dragash, Cnr.78/12 të datës 25.06.2013, të cilin aktgjykim i njëjti e kishte pranuar me datë 11.06.2014, e i cili aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datën 04.07.2014, në të cilin aktgjykim paluajtshmëria e pretenduar se është e të dëmtuarit në këtë rast në sipërfaqe prej 2,29 ari, e locuar në parcelën kadastrale në vendin "...", me numër 3530, evidentuar në listën poseduE. nr.133 zona kadastrale ... është bartur në emër të paditësve të atëhershëm, S.M dhe H.E, të gjithë nga fshati ..., Komuna e Dragashit, me të cilat veprime këtu të dëmtuarit L.Ki ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material,

Këso dore ka kryer veprën penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.1 e lidhur me nenin 1 par.1 te KP-ës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 42 par.1 pika 1.1 dhe 1.2, 43 par.1 pika 1.3, 46, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75,76 dhe 342 par.1 e lidhur me par.2 te KP-ës, te akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 300 (treqind) Euro, të ilën shumë i akuzuari është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin e shqiptuar me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20,00 euro një ditë burgim, respektivisht 15 ditë burgim, dhe

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale.

I dëmtuari L.K, nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari qe ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumen prej 30,00 Euro, si dhe në emër të mbrojtjes së viktimave shumë prej 30,00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për krime të rënda, kësaj gjykate Departamentit për krime të rënda i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.139/2015 të datës 18.08.2015, kundër të akuzuarit M.S, nga fshati ..., komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga nenin 422 par.1 të KP-së,

Me aktvendimin e kësaj gjykate Departamentit për krime të rënda P.nr. 152/2015 të datës 30.09.2015, Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për krime të rënda në çështjen penale kundër të akuzuarit M.S, nga fshati ..., komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga nenin 422 par.1 të KP-së, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe lënda është dërguar Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Dragash, si gjykatë me kompetencë lëndore, pasi që prokurori i shtetit para shqyrtimit fillestar ka bërë ricilësimin e veprës penale ashtu që në vend të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga nenin 422 par.1 të KP-së, cilësohet në veprën penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.1 e lidhur me par.2 të KP-së, andaj duke marrë parasysh ricilësimin e veprës penale, dhe vepra e ricilësuar është në kompetencë lëndore të Departamentit të përgjithshëm, e njëjta është dërguar Departamentit të Përgjithshëm të kësaj gjykate, përkatësisht degës në Dragash, në kompetencë lëndore, me që kjo vepër penale në

kuptim të dispozitave të nenit 22 të KPP-së, nuk është paraparë si vepër e rëndë penale, përkatësisht kjo vepër penale nuk hynë në kuadër të Departamentit për krime të rënda.

Gjykata themelore në Prizren – Dega në Dragash, në këtë çështje penale pas mbajtjes të shqyrtimit gjyqësor ka marrë me aktgjykimin P.nr.136/2015 me datë 25.01.2017, me të cilin aktgjykim të akuzuarin M.S, e ka shpallur fajtor për veprën penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.1 e lidhur me nenin 1 par.1 të KP-ës.

Kundër aktgjykimit të lartëcekur Prokuroria Themelore në Prizren, me datë 02.05.2017, mbrojtësi i të akuzuarit me datë 20.04.2017 dhe vetë i akuzuari me datë 14.04.2017, kanë parashtruar ankesa nëpërmjet kësaj gjykate në Gjykatën e Apelit.

Si dhe vetë akuzuari me datë.11.05.2017, ka parashtruar përgjegje në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren të datës 02.05.2017, nëpërmjet kësaj gjykate në Gjykatën e Apelit.

Gjykata e apelit me aktvendimin e saj PA1.nr.668/17 të datës 29.10.2018 e ka anuluar aktgjykimin P.nr.136/2015 me datë 25.01.2017, të Gjykatës themelore në Prizren – Dega në Dragash dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor dhe ka vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës të apelit të theksuara në aktvendimin e saj PA1.nr.668/17 të datës 29.10.2018

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 07.05.2019 prokurori i shtetit pas leximit të aktakuzës PP.nr.139/2015 të datës 18.08.2015, ka bërë përmirsimin e të njëjtës sa i përket përshkrimin faktik të dispozitivit të aktakuzës dhe se e njëjta duhet të jetë Prej datës 11.06.2014 e deri me datë 26.06.2014 në Dragash, i pandehuri gjatë përfaqësimit për interesa pasurore si përfaqësues në cilësinë e avokatit i të paditurit – në këtë rast të dëmtuarit L.K, nuk i përmbush obligimet dhe detyrimet e tij sipas autorizimit, nuk paraqet ankesë kundër aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Dragash, Cnr.78/12 të datës 25.06.2013, të cilin aktgjykim i njëjti e kishte pranuar me datë 11.06.2014, e i cili aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datën 04.07.2014, në të cilin aktgjykim paluajtshmëria e pretenduar se është e të dëmtuarit në këtë rast në sipërfaqe prej 2,29 ari, e locuar në parcelën kadastrale në vendin "...", me numër 3530, evidentuar në listën poseduE. nr.133 zona kadastrale ... është bartur në emër të paditësve të atëhershëm, S.M dhe H.E, të gjithë nga fshati ..., Komuna e Dragashit, me të cilat veprime këtu të dëmtuarit L.K i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material,

Prokurori i shtetit Naim Gashi, në fjalën e tij përfundimtare deklaron se: ngeli në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.139/15 të dt.18.08.2015, të rikualifikuar sipas procesverbalit të dt.30.09.2015, procesverball i shqyrtimit të mbajtur në Gjykatën Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të rënda, me të cilin është bërë rikualifikimi nga vepra penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 i KP, në veprën penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.1 lidhur me par.2 të KP, si dhe në përmirësimin e përshkrimin të gjendjes faktike të aktakuzës të përmirësuar në shqyrtimin gjyqësor të dt.07.05.2019.

Gjendja faktike e përshkruar është vërtetuar gjatë seancave gjyqësore të mbajtura në këtë gjykatë e që është deklarimi i të dëmtuarit si dhe deklarimi i dy dëshmitarëve dhe vet deklarimi i të akuzuarit, me çka vërtetohet se i akuzuari M.S në cilësin e avokatit gjatë përfaqësimit apo kujdesit për interesat pasurore të këtu të dëmtuarit L.K, lidhur me çështjen

civile, C.nr.78/12 i njëjti nuk i ka përmbushur detyrimet e tij, me çka me këto veprime i ka shkaktuar dëm këtu të dëmtuarit, interesat pasurore të cilit i ka përfaqësuar në cilësi të avokatit e që me rastin e aktgjykimit Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Dragash, aktgjykimi me numër të cekurë më lartë C.nr.78/12, i njëjti nuk ka paraqitur ankesë, në afatin e paraparë ligjor, gjë që si pasojë e mos paraqitjes së ankesë, këtu i dëmtuari e ka humbur kontestin civil e që rrjedhimisht i dëmtuari në këtë kontest e ka humbur kontestin civil dhe parcela në fjalë është bartur në emër të paditësve,

E që me këtë rast të dëmtuarit L.K i është shkaktuar dëm pasuror, i propozoj gjyqtarit gjykues bazuar në të gjitha këto të cekura, e duke marrur për bazë të gjitha rrethanat si ato rënduE. ashtu edhe ato lehtësuE. të akuzuarin të shpallë fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet sipas rikualifikimit të veprës penale, andaj i propozojë gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor për veprën penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.1 lidhur me par. 2 të KP-së, dhe ti shqiptojë dënim merititor sipas ligjit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit, av.V.K, fjalën e tij përfundimtare e parashtron në form të shkruar dhe atë në tri kopje identike,

Gjykata konstaton që nga tri kopje me shkrim të fjalës përfundimtare një kopje mbetet në shkresat e lëndës, ndërsa nga një kopje i dorëzohet të akuzuarit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit të shtetit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit av.V.K, pas dorëzimit të fjalës përfundimtare dëshiron të shtojë se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, parashtrorinë e kërkesë pronësoresh juridike, për lartësin e të cilës do ta precizojmë në kontest të rregullt civil, po ashtu qëndrojmë pranë ndjekjes së mëturshme penale, ndaj këtu të akuzuarit M.Spër veprën penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.1 lidhur me par.2 të KP.

Në fund edhe në pika të shkurta e laburon gojarisht fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.Sehadin Beqiri, fjalën e tij përfundimtare e parashtron me shkrim në tri kopje identike, dhe të njëjtat i dorëzon gjykatës.

Gjykata konstaton se një kopje e fjalës përfundimtare me shkrim mbetet në shkresat e lëndës ndërsa dy kopje të tjera të fjalës përfundimtare me shkrim të mbrojtësit të akuzuarit i dorëzohen prokurorit dhe përfaqësuesit të dëmtuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit deklaron që dëshiron që pos të cekurave në fjalën përfundimtare me shkrim të shtojë edhe atë se ne si mbrojtje konsiderojmë që i akuzuari M.S në ditën kritike nuk ka krye veprën penale keqpërdorim i besimit nga neni 342 par. 1 lidhur me par. 2 të KP, pasi që i njëjti gjatë procedurës ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme në pajtim me ligjin, kur gjykata me aktgjykimin e saj C.nr.78/12 ka angazhuar ekspertin e gjeodezisë M.H, i cili në ekspertizën e vet ka theksuar gjenezën e parcelës lëndore ..., zona katastrale ..., atëherë është vërtetuar se parcela e cekurë asnjëherë nuk është evidentuar në emër të H. dhe Z.H, me të cilët i dëmtuari L.K ka konsideruar që e ka blerë këtë parcel, aq më shumë i njëjti nuk ka pasur asnjë kontratë me shkrim të përpiluar për blerjen e kësaj parcele nga H. dhe Z.H, me aktgjykimin C.nr.78/12 të dt.25.06.2013, paditësve S.M dhe H., E se, iu është pranuar e drejta e pronësisë në parcelën lëndore në bazë të trashigimis, pasi që gjykata në atë procedurë në mes tjerash ka bërë shikimin në aktvendimin e ish Gjykatës Komunale në

Dragash, T.nr.20/62 të dt.28.01.1962, në bazë të cilit aktvendim nga ana e gjykatës është bërë ndarja fizike e trashigimis paraardhësit të paditësve, atëherë ka qenë e qartë se i akuzuari M.S nuk ka pasur asnjë provë që të parashtrijë ankesë. Me ankesën eventuale të parashtruar procedura vetëm do të zhagitej, dhe do të riteshin shpenzimet procedurale për të paditurin, në rastin konkret këtu të dëmtuarin.

Veprimet e veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 342 par. 1 lidhur me par. 2 të KP, përbëhet nga këto elemente, se kur personi nuk e kryen obligimin e vet apo e keqpërdor autorizimet e veta me qëllim që vetit apo dikujt tjetër ti sigurojë fitim të kundërligjshëm ligjor apo të shkaktojë dëm personit të cilat interesa i përfaqëson.

Në atë procedurë av.M.S, nuk realizuar asnjë fitim të kundërligjshëm e as diçka kështu gjatë procedurës nuk është vërtetuar, nuk i ka mundur dikujt tjetër që të arrijë fitim të kundërligjshëm. Paditësit në procedurën e cekurë kanë realizuar të drejtën e pronësisë në parcelën lëndore sipas të drejtës së trashigimis pasi që në bazë të trashigimisë para shumë viteve kanë arritur të drejtën e pronësisë në parcelën ..., më herët numri i vjetër Këtë të drejtë vetëm është vërtetuar në aktgjykimin C.nr.78/12.

Av.M.S në situatën e dhënë duke mos pasur asnjë provë e as argument për parashtrimin e ankesës e ka shfrytëzuar të drejtën destruktive të cilën ia jep neni 90 të LPC.

Në pjesën tjetër mbetem pranë fjalën përfundimtare me shkrim.

I akuzuari M.S në fjalën përfundimtare deklaron: në tërësi jam i pajtimit dhe e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim duke shtuar që gjatë shqyrtimit gjyqësor që unë si i autorizuar në kontestin civil kam kryer veprën penale të keqpërdorimit të besimit nga neni 342 par. 1 lidhur me par. 2 të KP-së. Kjo nga fakti se unë si përfaqësues këtu të dëmtuarit, në kuptim të nenit 90 të LPC, kam mundur të mos parashtrijë ankesë në aktgjykim pasi në kuptim të kësaj dispozite të këtij ligji ankesa nuk është e domosdoshme, por i është dhënë e drejta e të autorizuarit i cili është avokat që vet të vlerësojë se a do të parashtrijë ankesë, andaj nëse vlerëson se ankesa nuk do të ketë sukses, atëherë për shkak ekonomizimit të procedurës mund të heqë dorë nga parashtrimi i ankesës. Në procedurë nuk është provuar se unë me mos parashtrimin e ankesës të kem realizuar dobi pasurore e as dëshmitarët e dëgjuar të kenë vërtetuar këto të dhëna të aktakuzës. Pos të paraqiturës edhe parashtrimi i mjetit të jashtëzakonshëm juridik nuk ka qenë efikas ngase është treguar se vendimi i gjykatës në atë procedurë civile ka qenë e ligjshme.

Nga e paraqitura i propozojë gjykatës që konform nenit 363 dhe në mungesë të përgjegjësisë të më lirojë nga kjo aktakuzë.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Prej datës 11.06.2014 e deri me datë 26.06.2014 në Dragash, i pandehuri gjatë përfaqësimit për interesa pasurore si përfaqësues në cilësinë e avokatit i të paditurit – në këtë rast të dëmtuarit L.K, nuk i përmbush obligimet dhe detyrimet e tij sipas autorizimit, nuk paraqet ankesë kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Dragash, Cnr.78/12 të datës 25.06.2013, të cilin aktgjykim i njëjti e kishte pranuar me datë 11.06.2014, e i cili aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datën 04.07.2014, në të cilin aktgjykim paluajtshmëria e pretenduar se është e të dëmtuarit në këtë rast në sipërfaqe prej 2,29 ari, e locuar në parcelën kadastrale në vendin "...", me numër 3530, evidentuar në listën poseduE.

nr.133 zona kadastrale ... është bartur në emër të paditësve të atëhershëm, S.M dhe H.E, të gjithë nga fshati ..., Komuna e Dragashit, me të cilat veprime këtu të dëmtuarit L.K i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material,

Gjykata pas vlerësimit të gjitha shkresave dhe provave të lëndës dhe ate: deklaratës të akuzuarit, të dëmtuarit - dëshmitarit, dëshmitarëve A.K dhe A.K.2, si dhe provave materiale dhe ate Aktgjykimi i plotfuqishem i Gjykates Themelore ne Prizren - Dega në Dragash P.br. 78/12 te dt. 25.06.2013, e plotfuqishme me dt. 04.07.2014, Çertifikata e AKK-se - Njesia kadastrale ne Dragash të dhenat baze per Njesi te AKK-se me numer te lartpermendur te Zyres kadastrale te Komunes ne Dragash te dt. 29.04.2013, kërkesa e te demtuarit L.K per inicimin e procedures disiplinore Prokurorise disiplinore te OAK-se ndaj te akuzuarit M.S te dt. 16.01.2015, Aktvendimi i Komisionit disiplinor te OAK-se ne Prishtine RDK nr. ... te dt.28.05.2015, me te cilin te akuzuarit M.S i u eshte shqiptuar masa disiplinore e gjobitjes ne shume prej 200,00 €. informata e zyres te Kryeprokurorit te shtetit adresuar te akuzuarit KMLC.nr. ... te dt. 28.01.2015, Aktgjykimi i Gjykates Komunale ne Dragash C.nr. ... te dt. 02.12.2009. Ankesa e parashtruar Gjykates Komunale ne Dragash per Gjykatën e Qarkut ne Prizren te autorizuarit te paditurit L.K avokat M.S te dt. 31.12.2009, Aktvendimi i Gjykates se Qarkut ne Prizren Ac.nr. 54/2010 te dt. 05.07.2012, shkresa e te autorizuarit te paditurit L.K avokat M.S nga Dragashi te parashtruar Gjykates Themelore ne Prizren - Dega ne Dragash te dt. 13.03.2013, Aktgjykimi i Gjykates Themelore ne Prizren - Dega ne Dragash C.nr. 78/12 te dt. 25.06.2013. kërkesa per mbrojtjen e Ligjshmerise te parashtruar Prokurorise se shtetit te Kosoves ne Prishtine nga ana e te paditurit kunder paditesit L.K te dt. 02.07.2014, lajmerimi i zyres se Kryeprokurorit te shtetit KMLC.nr. 70/14 te dt.05.08.2014, te parashtruar avokatit M.S. Vendimi i mosëprovueshëmrise të Gjykatës KushtetuE. sipas paarshtuesit L.K, me numër të rastit Ki.nr.59/15 të datës 06.04.2016; Aktvendimin e Gjykates Komunale ne Dragash C.nr. 80/06 te dt. 18.07.2006, çertifikata e Njesise kadastrale te Komunes se Dragashit me numer P-... te dt. 08.05.2015, raporti psikiatrik lidhur me mendimin psikiatrik për të dëmtuarin L.K të datës 27.08.2019, aktgjykimi C.nr.78/2012 i datës 25.06.2013 i plotëfuqishëm me datë 04.07.2014, autorizimi i dhënë nga i dëmtuari L.K në cilësinë e të paditurit të dhënë me datë 29.06.2009, për përfaqësuesin e autorizuar av.M.S, fletëdërgesa e Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Dragash, në gjuhën serbokroate P.nr.78/12 për pranimin e aktgjykimit të datës 25.06.2013 me të cilën konstatohet se i njëjti ka pranuar aktgjykimin e ekur me datë 11.06.2014, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për krime të rënda P.br.196/2015 të datës 14.03.2016 i plotëfuqishëm me datë 01.08.2016, formulari i kërkesës në emër të L.K dhe aktvendimi i Gjykatës KushtetuE. me numër të rastit KI.nr.... të datës 15.03.2016, padia e paditësit L.K, nga fshati ... të parashtruar me datë 08.05.2015, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren -Dega në Dragash për hudhje poshtë të padisë .nr.38/2015 të datës 14,07.2015, aktvendimi i Gjykatës të Apelit në Prishtinë A.nr.... të datës 23.01.2017, aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.... të datës 08.03.2018, pra në rastin konkret gjykata në këtë mënyrë edhe ka vërtetuar përgjegjësinë penalo juridike të akuzuarit, nga kjo del se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të keqëpërdorimi i besimit nga neni 342 par.1 e lidhur me par.2 te KP-ës, duke vërtetuar paraprakisht përgjegjësinë penalo juridike të akuzuarit.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e vërtetoi në bazë të deklaratës të dëmtuarit - dëshmitarit L.K, i cili në shqyrtimin gjyqësor me datë 25.10.2016, deklaroi po e njoh, ketu te akuzuarin, e di qe eshte nga fshati ..., Komuna e Dragashit, dhe e di qe e kam autorizuar ne nje ceshtje civile per te mbrojtur interesat e mia juridike. Kam paguar per secilen

seance gjyqesore dhe perfaqesim nga 100 Euro. I kam ofruar te gjitha provat materiale qe vertetonin ceshtjen e interesave te mia juridike te parces, te gjitha provat materiale qe mi ka kerkuar i autorizuari im une ja kam dhene, Nuk mund te deklarohem lidhur me konkretizimin e emerimeve te atehere provave, pak edhe per nga koha e kalumen, por edhe per nga mosha, bashke punimi yne ka qene ne rregull, sic theksova me lart, por me vone me ka tradhtuar duke bashke punuar me palen e kundertë, pala e kundert ka qene deshmitari i propozuar nga ketu i akuzuari, nje fare H.i, mbiemrin e te cilit per momentin nuk e di, i cili eshte nga fshati yne ..., kete e bazoi ne faktin qe te gjitha te dhenat qe une i kam ofruar, i njeiti i ka perdorur per interesat e palet te kundert, kete mund ta konstatoj me faktin qe i njeiti pronen time e ka bartur tek pala e kundert, padijen time dhe pa njohurin time.

Kam dhene deklarate tek prokurori i shtetit dhe qendroj ne teresi pranë të njëjtës, kontestin civil kemi filluar nga viti 2004. Pala e kundert ne kontestin e rregullt civi kane qene tre vellezer te familjes E., dy nga ata kane vdekur ndersa gjalle ende eshte ne jete i vetmi nga ata dhe ate H. E.. Kontesti civil qe më ka perfaqesuar ketu i akuzuari ka zgjatur diku rreth 12 vite, edhe me teper, Perfundimi i tere ketij kontestit ka qene ashtu qe kur e ka marr vendimin perfundimtar, kam kuptuar qe pasuria ime, i eshte bartur ne pronesi ne baze te atij vendimi pales se kundert gjegjesisht familjes E., me te marr vendimin e cekur, kam shkuar tek nje avo kat ne Prizren, i cili me ka njoftuar me permbajtjen e atij vendimi, e pas kesaj kam shkuar edhe ne oden e avokateve ne Prishtine, per ta paraqitur rastin me arsyetim qe paraprakisht u njoftova qe per shkak te leshimeve te disa veprimeve juridike te autorizuarit tim ketu te akuzuarit, toka ime te cilen e kam punuar me shume se 50 vite i eshte dhene ne pronesi pales se kundert. Pas verejtjes sime dhe paraqitjes se rastit ne eden e avokateve, te njejtit kane ndermarre procedurat e tyre te brendshme ndaj ketu te akuzuarit, te cilat vendime i posedon perfaqesuesi i imi tashem. Prona kontestuE. gjendet ne fshatin ..., siperfaqja e pasurise tuaj tani te bartur tek familja E. ka qene 229 meter katror, ne vendin ku gjendet vlere materiale eshte 150 per meter katror. Janë mbajtur 20-30 seanca gjyqësore per periudhen 12 vjecare te kontestit. Kur ka perfunduar ceshtjen kontestuE. ne gjykate, ka ardhur i autorizuari ketu i akuzuari per te prezantuar aktgjykimin me shkrim dhe per te më njoftuar lidhur me perfundimin e saj, me ka prezantuar dhe me ka njoftuar qe e kam humbur kontestin, dhe kur jam njoftuar qe e kam humbur kontestin, atehere e kam revokuar autorizimin ndaj tij. Dua te theksoj qe dokumentacionin qe une i kam ofruar ketu te akuzuarit, disa nga dokumentacionit nuk rra ka kthyer, dhe ende gjenden te i njeiti.

Kur kam shkuar ne zyre e katastrit prane Kuvendit Komunal ne Dragash, kam kerkuar nje dokument lidhur me pronen kontestuE., e aty me kane thene qe nuk kam drejte ne dokumente per pronen kontestuE., ngase e njejtja tani eshte prone e pales ime kundertshtare. Une personalisht nuk e kam pare qe ketu i akuzuari M.Ska qene ne shoqeri me vellezerit E., konkretisht S., M. apo H. E. nga fshati ..., por kam degjuar qe ne fshatin... eshte organizuar nje banket me rastin e fitimit te pasurise familjes E., mu ajo prone qe une e kam humbur, e i cili banket ka qene i organizuar nga djali i ketu te akuzuarit dhe nga djali i H. E., kjo me qellim te festohet dhe te kremtohet fitimi i pasurise. Ne kete bankete ka qene prezente edhe ketu i akuzuari M.S.

I akuzuari ka kërkuar nga unë si i demtuar plotesim te provave si dhe deshmitar te ri qe te rifillohet procedura gjegjesisht te vazhdoj procedura ne ceshtjen

civile, dhe ka kerkuar nje leter te para 100 viteve, po ashtu ke kerkuar edhe emra qe ne cilesi te deshmitareve te ftohen disa miq te fshatit qe kane pasur moshe te shtyer, e disa nga ta edhe kane vdekur.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 20.08.2019, prokurori i shtetit në bazë të shiqimit të drejtëpërdrejt të gjendjes shëndetësore për shkak të moshës propozon që të dëmtuar – dëshmitarit L.K, me anë të ekspertizës të eksperit të lëmisë gjegjëse të vërtetohet aftësia juridike e këtu të dëmtuarit – dëshmitarit, të cilin propozim gjykata e aprovoi me vendimin e saj të datës 20.08.2019,

Eksperti i psikiatrisë Dr,Sci. N.M, me datë 27.08.2019 gjykatës i ka parashtruar raportin psikiatrik me shkrim në të cilin raport ka dhënë mendimin dhe konkludimin se L.K, ka aftësi juridike për të qenë palë në proedurë.Duhet të merren parasysh specifikat e moshës dhe të nivelit intelektual – edukativ

Në vazhdim në shqyrtimin gjyqësor me datë 06.09.2019, i dëmtuari – dëshmitari L.K, deklaroi: Nuk kam kurfar vendimi për mua, avokati ka qenë i autorizuar nga ana ime që të kryej këtë punë, nga unë ka marrë të holla dhe nuk më ka përfunduar kurfar pune dhe në përfundim të kësaj e ka bartur pronësinë palës tjetër e cila më ka paditur, i kam mbetur borxh vetëm 10 euro

Të dëmtuarit – dëshmitarit L.K, i lexohet deklarata e të njëjtit e dhënë me datë 25.10.2016, pranë të cilës deklaroi se qëndron në tërësi dhe shtoj në fund që dëshiroj që kjo pronë të më kthehet dhe të më kompenzohen të gjitha shpenzimet dhe si palë e dëmtuar parashtror kërkesë pronësoresh juridike për lartësinë e të cilës do të sqarohet në kontest civil.

Unë kam qenë në cilësinë e të paditurit nga ana e paditësit E.E, kur më ka përfaqësuar i akuzuari mua.Gjatë kontestsit që ka zgjatur 12 vite te i akuzuari nuk mund të di saktë sa herë kam qenë, por nëse për një vit të kisha ardhur një herë brenda vitit atëherë i bije që kam qenë 12 herë, por unë mendoj se kam qenë më shumë herë te i akuzuari

Dëshmitari A.K.2, në shqyrtimin gjyqësor me datë 22.11.2016, deklaroi: jo nuk jetoj ne bashkesine familjare me te demtuarin L.K, deri ne vitin 1981 kemi jetuar në bashkësi familjare. E di qe ka pasur nje kontest ku e ka paditur E.E, ka kerkuar vendosjen e megjeve, ngase jemi ne megje me te njejtin. Xhaxhai im për këtë ka angazhuar këtu të akuzuarin M.S, këtë e kam kuptuar nga xhaxhai, kontesti i cekur me larte ka filluar para 10-11 viteve.Vendi gjendet ne vendin e quajtur "...", ne siperfaqe prej 450m2, ndersa siperfaqja qe i ka takuar xhaxhait tim eshte 229m2.Prona eshte troll, ndersa gjendet ne mes te fshatitÇmimi per 1m2 eshte 150-160,00 €, kete e them ne baze te vleres te sotme, e duke u bazuar ne tregun e lire ne fshatin ... sa i perket cmimeve.Sa kemi qene ne bashkesine familjare me xhaxhain e juaj, kjo pronë ka qenë ne emer te xhaxhait tim L.K, - fjala eshte per 229m2. Ka qene dikur rreth 40 vite, deri sa i njejt i humbi kontestin me rastin e angazhimit te ketu te akuzuarit ne cilesine e avokatit. Para 40 viteve kjo toke ka qene kullose, sa me kujtohet mua nga fjalet e babait tim, ndersa sot e njejta prone eshte sipas kultures troll. Kjo i takon xhaxhait tim. Nuk kam qenë prezent kur xhaxhai im i ka dhene autorizimin te akuzuarit, nuk mare pjE. ne ndonje seance gjyqesore lidhur me kete ceshtje - fjala eshte per kontestin pronesore

Ne fillim te ketij kontesti nga xhaxhai im ketu i demtuari L.K, kam kuptuar qe eshte i autorizuar i tij këtu i akuzuari,. me ka treguar disa here me heret lidhur me pakenaqesine e tij me punen e të akuzuarit si autorizuar i tij ne ceshtjen pronesore, por

une kam ditur qe duke pasur parasysh qe i akuzuari eshte i aries tone, vendasi i yni, i njejti eshte i paguar per te kryer kete pune, i njejti do te perfundoj kete pune, une kam qene i bindur qe toka do te i takoj xhaxhait tim, por nuk ndodhi ashtu. Çmimin per meter katror sic e theksova me larte ne fsh. ..., i cili cmim munde te valuroj 10-20 € poshte larte, lirishte per kete te dhene munde te ofroj 10 - 15 deshmitare vendas, anas te kesaj ane. Theksova me larte qe kemi jetuar ne bashkesine familjare deri ne vitin 1981, me rastin e shkeputjes te bashkesise familjare me ane te trashegimise nga ana e gjyshit tim, kjo prone i ka takuar xhaxhait tim ketu te demtuarit L.K.

Dëshmitari A.K.2, në shqyrtimin gjyqësor me datë 12.11.2019, deklaroi: më kujtohet se kam dhënë deklaratë në cilësinë e dëshmitarit me datë 22.11.2016, në këtë çështje penale, po mbetem pranë të njëjtës në tërësi. Parcela e cila ka qenë objekt i çështjes civile sot me kulturë është truall, mbajtës i lësaj parcele ka qenë xhaxhai im, këtu i dëmtuari L.K dhe edhe ditën e sotme i njëjti e mbanë këtë pronë, po jam në dijeni për aktgjykimin C.nr.78/2012 të datës 26.06.2013, me të cilin aktgjykim prona e xhaxhait tim ka kaluar në pronësi të palës së kundërt familjes E. dhe xhaxhai im në këtë çështje është i dëmtuar.

Po edhe në ditën e sotme ende xhaxhai im e mbanë këtë tokë edhe përkundër aktgjyqimit të cekur më lartë në kontestin civil të kësaj gjykate edhe familja E. e cila e ka fituar pronësinë e dinë që kjo tokë është tokë e jona,

Kam qasje në aktgjykimin e cekur C.nr.78/2012 të datës 26.06.2013, çka është vendosur me këtë aktgjykim personalisht e din më mirë i akuzuari sepse nuk ka parashtruar ankesë. Po sot është e vërtet se xhaxhai im e mbanë pronën – trolin e cekur, por sa i përket dëmtimit 17 vite i akuzuari e ka maltretuar me shpenzime të larta xhaxhain tim pasi që ka qenë i autorizuar që të mbroj interesat e xhaxhait tim e jo që të marrë pasurinë e xhaxhait tim familja E.

Dëshmitari A.K, në shqyrtimin gjyqësor me datë 22.11.2016, deklaroi: po jetonj me të atin tim te atin ketu te demtuarin në bashkesi familjare. Babai im ka pasur konteste me me H. E., lidhur me pronen tone, e cila gjendet ne vendin e quajtur "...", e cila gjendet ne fshatin ..., ne qender te fshatit. Ky kontest pronesor ka filluar para 10-11 viteve. Babai im te autorizuar ne kete ç eshtje e ka pasur M.Sn, e ka angazhuar personalisht babai im, menjehere ne fillim te kontestit e kam ditur që babai im e ka angazhuar të njëjtin. Unë nuk kam kontaktuar personalisht me te autorizuarin e babait tim, ketu te akuzuarin, nuk kam prezantuar prezantuar ndonjehere ne seanca gjyqësore lidhur me këtë kontest, nuk kam kontaktuar personalisht me të akuzuarin si i autorizuar i babit tim, Ne funde te vitit 2014, kam kuptuar për humbjen e kontestit, me tregoji vellai im V.K, i cili momentalisht eshte ne pune te perkohshme ne Itali. I njëjti ka qene ne Drejtorin e kadastrit per te u pajisur me listen poseduE. per kete prone, dhe ka verejtur qe kjo prone nuk figuron me ne emrin e babait tone. Babai im apo ne si familjar nuk kemi pranuar ndonjehere ndonje vendim nga gjykata qe e kemi humbur kontestin e cekur. I autorizuari ynë – këtu i akuzuari nuk ka qenë në shtepine tonë, per te prezantuar ndonje prove qe e kemi humbur kontestin. Per fatin e kesaj prone kemi pasur bisede familjare ne vitin 2014 kur e kemi humbur kontestin, e paraprakisht babai me ka njoftuar qe ka nje njeri profesional i cili do te perfundoj punen sa i perket fitimit te pronesise ne kontest pronesor. Çmimi i tregut per meter katror te kesaj pasurie sipas vleresimi tim te lire eshte afer 200,00 € per meter katror. Une e di qe nuk e kemi humbur, une nuk do te ndalem do te vazhdoj edhe me tutje, qe te kerkoj pronen e familjes time nepermjet gjykates. Me humbjen e ketij kontesti po konsideroj qe jemi te demtuar si familje, pasi qe kemi qene neper gjykime gati 11

vite. Kjo prone para se te humbim ka figuruar ne emer te babait tim L.Kdhe ate rreth 40 vite.

E di qe familja E. qe e ka fituar kontestin, për çka se bashku me te birin e ketu te akuzuarit kane festuar ne nje lokal ne fshatin..., me ka njoftuar nje mik nga fshati qe i ka pare. Objekt i ketij kontesti ka qene vetem megja, ashtu se paku kam menduar une, por qe do ta humbim tere pronen dhe ate per shkak te mos parashtrimit te ankE.s nga ana e te autorizuarit tone ketu te akuzuarit, kete nuk e kam besuar. sipërfaqja e teresishme e prones eshte 450m2, nga po te njejta ne si familje keni pretenduar qe jeni pronare prej 229m2, si perfaqja e mbetur prej 221m2 ka qenë e familjes E., Ne në këtë kontest kemi qene ne cilesine e te paditurit.

Dëshmitari A.K, në shqyrtimin gjyqësor me datë 12.11.2019, deklaroi:Po është e vërtetë dhe më kujtohet deklarata e dhënë me datë 22.11.2016, po mbetem pranë deklaratës së lartëcekur, këtu të dëmtuarin e kam baba, jetojmë në një oborr, ndërsa amvisërinë e kemi të ndarë. Me datë 25.06.2013, kur është marrë aktgjykimi C.nr.78/2012, kam qenë në bashkësi familjare me babain tim. Me aktgjykimin e cekur sipërfaqja kontestuE. ka kaluar në emër të familjes E. dhe ate në emër të A., S.dhe M.t E., të tre nga fshati ..., komuna e Dragashit. Babai im L.K, aktgjykimin e cekur kur në dorë, nuk i është dhënë kur nga askush. Sot prona kontestuE. evidentohet në emër të A., S. dhe M.E., Po e konsiderojmë veten të dëmtuar, unë personalisht dhe familja ime

Po e vërtet është që toka – trolli është evidentuar në emër të familjes E., po gjithashtu është e vërtet që babai im e mbanë këtë tokë-troll, ngase tërë fshati e din që ky truall është i familjes tonë dhe se këtu i akuzuari e ka mashtruar babain tim ngase ne e kemi autorizuar që të mbroj pronën tonë e jo që e njëjta të bartet te familja E.. Po ne kemi prova, listën poseduE. nga shërbimi kadastral këtu në Dragash, zona kadastrale Restelië, që kjo pronë – tokë është pronë e familjes sonë K., të njëjtat prova i kemi dorëzuar në dispozicion këtu të akuzuarit si mbrojtës i autorizuar i familjes sonë

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 12.11.2019, janë administruar edhe provat materiale dhe ate Aktgjykimi i plotfuqishem i Gjykses Themelore ne Prizren - Dega në Dragash P.br. 78/12 te dt. 25.06.2013, e plotfuqishme me dt. 04.07.2014, Çertifikata e AKK-se - Njesia kadastrale ne Dragash P-.... të dhenat baze per Njesi te AKK-se me numer te lartpermendur te Zyres kadastrale te Komunes ne Dragash te dt. 29.04.2013, kerkesa e te demtuarit L.K per inicimin e procedures disiplinore Prokurorise disiplinore te OAK-se ndaj te akuzuarit M.Ste dt. 16.01.2015, Aktvendimi i Komisionit disiplinor te OAK-se ne Prishtine RDK nr. ... te dt.28.05.2015, me te cilin te akuzuarit M.Si u eshte shqiptuar masa disiplinore e gjobitjes ne shume prej 200,00 €. informata e zyres te Kryeprokurorit te shtetit adresuar te akuzuarit KMLC.nr. ... te dt. 28.01.2015, Aktgjykimi i Gjykses Komunale ne Dragash C.nr. ... te dt. 02.12.2009. Ankesa e parashtruar Gjykses Komunale ne Dragash per Gjyksen e Qarkut ne Prizren te autorizuarit te paditurit L.K avokat M.Ste dt. 31.12.2009, Aktvendimi i Gjykses se Qarkut ne Prizren Ac.nr. ... te dt. 05.07.2012, shkresa e te autorizuarit te paditurit L.K avokat M.S nga Dragashi te parashtruar Gjykses Themelore ne Prizren - Dega ne Dragash te dt. 13.03.2013, Aktgjykimi i Gjykses Themelore ne Prizren - Dega ne Dragash C.nr. 78/12 te dt. 25.06.2013. kerkesa per mbrojtjen e Ligjshmerise te parashtruar Prokurorise se shtetit te Kosoves ne Prishtine nga ana e te paditurit kunder paditesit L.K te dt.

02.07.2014, lajmerimi i zyres se Kryeprokurorit te shtetit KMLC.nr. 70/14 te dt.05.08.2014, te parashtruar avokatit M.S. Vendimi i mosëprovueshëmrës të Gjykatës Kushtetuese sipas paarshtuesit L.K, me numër të rastit Ki.nr.59/15 të datës 06.04.2016;Aktvendimin e Gjykates Komunale ne Dragash C.nr. 80/06 te dt. 18.07.2006, çertifikata e Njesise kadastrale te Komunes se Dragashit me numer P... te dt. 08.05.2015, raporti psikiatrik lidhur me mendimin psikiatrik për të dëmtuarin L.K të datës 27.08.2019, aktgjykimi C.nr.78/2012 i datës 25.06.2013 i plotëfuqishëm me datë 04.07.2014, autorizimi i dhënë nga i dëmtuari L.K në cilësinë e të paditurit të dhënë me datë 29.06.2009, për përfaqësuesin e autorizuar av.M.S, fletëdërgesa e Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Dragash, në gjuhën serbokroate P.nr.78/12 për pranimin e aktgjykimit të datës 25.06.2013 me të cilën konstatohet se i njëjti ka pranuar aktgjykimin e ekur me datë 11.06.2014,

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 05.12.2019, janë administruar edhe provat materiale dhe ate aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për krime të rënda P.br.196/2015 të datës 14.03.2016 i plotëfuqishëm me datë 01.08.2016, formulari i kërkesës në emër të L.K dhe aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese me numër të rastit KI.nr.59/2015 të datës 15.03.2016,

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 27.01.2020, janë administruar edhe provat materiale dhe ate padia e paditësit L.K, nga fshati ... të parashtruar me datë 08.05.2015, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren -Dega në Dragash për hudhje poshtë të padisë .nr.38/2015 të datës 14.07.2015, aktvendimi i Gjykatës të Apelit në Prishtinë A.nr.... të datës 23.01.2017, aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.... të datës 08.03.2018,

I akuzuari M.S, në shqyrtimin gjyqësor me datë 25.01.2017, në mbrojtjen e vet deklaron: po, kame pasur ne cilesine e Avokatit, nje autorizim nga ketu i demtuari L.K per ta perfaqesuar te njejtin ne nje ceshtje civile ne Gjykatën Themelore te Prizrenit - Dega ne Dragash. Aktgjykimin e Gjykates Themelore ne Prizren - Dega ne Dragash, C.nr.78/12, te dt. 25.06.2013, i bere i plotfuqishem me dt. 04.07.2014, e kame pranuar ne hapsirat e Gjykates Themelore ne Prizren - Dega ne Dragash. Po, kame pasur te drejte te parashtroj Anke. kunder Aktgjykimit te cekur ne emer te te paditurit tani te demtuarit, ne ditën kur e kame marr Aktgjykimin e cekur, ne shikim te pare kame verejtur dhe kame konstatuar qe Aktgjykimi eshte i ligjshem, por duke pasur parasysh qe kame qene ate dite ne hapsirat e Gjykates, dhe me vehte e kame pasur edhe nje lende tjeter, Aktgjykimin kontestues e kame lene ne mbeshtjellesin e shkresave te lendes tjeter, te cilen e kame perfaqesuar ne ditën e pranimit te Aktgjykimit.Nga kjo edhe ka ndodhur qe te njejten nuk e kame evidentuar ne orarin tim si dhe ne udhezimin e ankesave, andaj edhe nga kjo ka ndodhur qe nuk kame parashtruar Anke., e po ashtu ne drejtim te kesaj edhe faktit se ka qene nje bindje e ime qe edhe poqe. parashtroj anke. e njejta do te jete e pa sukseshme. ne marreveshje me ketu te derntuarin, atehere te paditurin, kame parashtruar Kerke. per mbrojtje te ligjshmerise prane Prokurorise se shtetit ne Prishtine, ne te cilen kerke. me eshte pergjigjur me shkrim prokuroriri i shtetit i cili me ka njoftuar qe nuk e ka pranuar kerke.n time per mbrojtje te ligjshmerise, per kete e kame njoftuar edhe tani te demtuarin, por i njejti ne ate kohe nuk ka shprehur pakenaqesi lidhur me refuzimin e prokurorit te shtetit per kerke.n e parashtruar per mbrojtje te ligjshmerise, e as qe ndaj meje te kete shprehur mosbesushmeri, si perfaqesues te tij. Nga une ka kerkuar se a ka mundesi qe te shfrytezojm edhe ndonje mjet tjeter juridik kunder Aktgjykimit te cekur. Une te demtuarit i kame propozuar qe mundemi te kerkojm perseritjen e procedures civile si mjet te jashtezakonshem

juridike, i demtuari është pajtuar me këte propozim. Në përgaditjen e kërkesës për perseritjen e procedurës nën të demtuari ka kërkuar që të me dorëzojë prova të reja të cilat prova nuk kanë qënë të njohura në procedurën paraprake civile, ka kërkuar që të me dorëzojë emrat e dëshmitarëve të cilët do të vërtetonin faktin që këtu i demtuari parcelën kontestuese. e cila ka qënë objekt i kontestit civil të këte blere dhe për të njëjten të këte paguar cmimin e shitblerjes ish pronarit, si dhe prove materiale lidhur me atë që parcela kontestuese. në katastrin përshkrues të Komunes së Dragashit, ka qënë e regjistruar në emër të ish pronarit gjegjësisht shitesit nga i cili këtu i demtuari e ka blere parcelën kontestuese.. Mirepo i demtuari ka ardhur tek nënë zyre dhe me ka lajmëruar që nuk ka dëshmitar të gjall të cilët do të vërtetonin faktet e cekura më lart, e as që ka pasur ndonjë leter si prove për shitblerje. Pa këto prova nuk ka mundur të përgadis kërkesën për perseritjen e procedurës.

Po, jam në njohuri që në bazë të këtij Aktgjykimi, pala e demtuar Lutfi K. e ka humbur kontestin ka qënë i vetdijshëm lidhur me këte fakt, dhe atë pasi që e ka pasur në dorë Aktgjykimin, por pasqhtë ka qënë i vetdijshëm që me këte Aktgjykim pala e kundërt, pra pala paditëse. ka pasur sukses në këst në bazë të provave të dispozueshme dhe me Aktgjykim të drejt të organit legal gjegjësisht të Gjykatës kompetente. Nënë me kërkesë. të të demtuarit të njëjtit i ka dorëzuar të gjitha shkresat e lëndës në fund të muajit dhjetor të vitit 2014, ashtu që nga dita e plotfuqishmerisë së këtij Aktgjykimi e deri në këte periudhë, sa e diç një ky Aktgjykim nuk ka ndryshuar.

Me vënë sa me është e njohur edhe personalisht i demtuari ka parashtruar kërkesë. Prokurorisë së shtetit të Kosovës, për parashtrimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmerisë si dhe në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ka iniciuar procedurën për kushtetutshmerinë dhe ligjshmerinë e Aktgjykimit të cekur, andaj edhe lidhur me rrezultatet e këtyre kërkesave të parashtruara nga ana e të demtuarit në Gjykatën kushtetuese., të njëjtat nuk me janë të njohura, andaj edhe nuk e diç si ka rrjedhur dhe në cilën fazë të procedurës është kërkesa e të demtuarit. Andaj nuk mundë të deklarohe më ka pasur ndonjë ndryshim nga Organet e lartëcekura lidhur me Aktgjykimin e këtij kontesti civil.

Lidhur me këtë ka pasur procedurë disiplinore, dhe Komisioni disiplinor pranë Odes së Avokateve me ka shqiptuar masën e gjobës në shumë prej 200,00 €, të cilën shumë nënë e ka paguar, dhe nuk ka marrë vendim e Komisionit disiplinor të Odes së Avokateve të Kosovës,

Nuk me kujtohet viti, se në cilin vit është ngritur padia e paditesve S. E., M. E. dhe H. E., kundër të paditurit L.K, i ka marrë detyrat e mia, i ka mbrojtur interesat pasurorë-juridike të të demtuarit në kontestin civil, mbrojtja e interesave pronësorë-juridike të këtu të demtuarit në kontestin civil është përbërë në ndërmarrjen e veprimeve të mija juridike dhe atë në rënd të parë me kontestimin e bazueshmerisë të padisë të paditesve, parashtrimin e të gjitha fakteve relevante dhe qënësore dhe provave të cilat kanë qënë në drejtim të të demtuarit, me praninë time të rregullt në çdo seancë gjyqësore të caktuar nga fillimi i procedurës civile e deri në marrjen e vendimit të shkallës së parë, pastaj në Aktgjykimin e parë të shkallës së parë dhe atë C.nr.132/2007, të dt. 02.12.2009, të marr nga ana e ish Gjykatës Komunale në Dragash, me të cilin Aktgjykim është aprovuar kërkesë.padija

e paditesve, kunder te cilit Aktgjykim kame parashtruar edhe AnKE. Gjykates se Qarkut ne Prizren, Ankesa eshte aprovuar dhe eshte prishur aktgjykimi i Shkalles se pare dhe lenda eshte kthyer ne rigjykim Gjykates se Shkalles se pare, pastaj, te demtuarit i kame dhene edhe keshilla tjera juridike, gjegjesisht qe parcelen kontestuE. ta rrethoj dhe me te te tregohet si shfrytëzues me mirebesim i kesaj parcele. Te gjitha keto te cekura me lart paraqesin veprime juridike, te cilat une si i autorizuar i te demtuarit i kame marr nc mbrojtjen e interesave pasuroro-juridike te te demtuarit. Nuk me kujtohet Aktgjykim para ketij Aktgjykimi qe ka qene marr nga ndonje gjykate lidhur me kete kontest civil.

Nuk e di qe kame parashtruar AnKE. kunder Aktgjykimit C.nr.168/05, te dt.12.06.2006, ne cilesine e te autorizuarit te te demtuarit, por nga shiqimi ne Aktvendimin e ish Gjykates se Qarkut ne Prizren Ac.nr.432/06, te dt. 03.09.2007, qe me eshte dhene ne shiqim, askund nuk figuron qe ky Aktvendim eshte marr sipas AnKE.s te ushtruar nga ana ime.Me ka paguar per veprimet e mia juridike sipas mendimit tim nen tarifen e pagesave te Avokateve, por ketu i demtuari nuk me ka paguar pagE.n perfundimtare, te cilen pagE. sipas marreveshjes sone eshte parapar te behet ne perfundim te çeshtjes, por pasi qe ka ardhur deri te situata qe eshte objekt i kesaj akuzue, pagE.n perfundimtare as nuk e kemi perlloritur, e kjo len te nenkuptohet qe as nuk me ka paguar.Gjate procedures civile, kame disponuar me prova qe ketu i demtuari ne emer te tij ka pasur te regjistruar parcelen katastrale kontestuE. ne sherbimin katastral te Komunes se Dragashit, ne emer te tij. Theksoj qe vet regjistrimi i paluajtshmerise ne sherbimin e katastrit ne emer te dikujt, konform ligjit te katastrit te paluajtshmerise, nuk do te thote qe vet regjistrimi ne kadaster edhe e drejta e pronesise,

I demtuari ka pasur fleten poseduE. ne emer te vet si pronar te parceses kontestuE., nuk më kujtohet nga cili vit i demtuari ka qene pronar i paluajtshmerise kontestuE.Me rastin e marrjes se Aktgjykimit te te demtuarit, e kame lexuar dispozitivin dhe arsyet e dhena te dispozitivit. Pasi qe arrita ne zyre, vazhdova punen me pale, dhe punet tjera te perditshme, ne nje moment e di qe aktgjykimin e cekur me shkresat e lendes tjeter qe e perfaqesoja ne gjykate e kame lene ne tavoline, une ne thelbin e saj e kame lexuar Aktgjykimin e cekur dhe te njejtin sipas permbajtjes se saj te dispozitivit e kame konsideruar te ligjshem, Aktgjykimin e kame kontrolluar edhe njehere pas 25-30 diteve kur ka ardhur i demtuari ne zyren time per tu interesuar per lenden dhe atehere e kame kuptuar qe e kame leshuar afatin per parashtrimin e ankE.s, ate dite kur ka ardhur ne zyren time, e kame njoftuar qe gjykata ka marr Aktgjykim ne dem te tij. Pas kuptimit qe e kam leshuar afatin e AkE.s, nuk kam aplikuar parashtrimin e kerke.s per kthim ne gjendjen e meparshme ngase kame vleresuar qe nje kerke. e tille nuk do te aprovohet nga ana e gjykates, nuk kam tentuar te arsyetoj mos parashtrimin e ankE.s si dhe pas kesaj te kerke.s per kthimin ne gjendjen e meparshme, ngase une me te demtuarin jemi marr vesh qe te parashtroj lutje prane Prokurorit te shtetit te Kosoves, per mbrojtje te ligjshmerise, pas plotfuqishmerise se Aktgjykimit, kjo parcele a ka kaluar ne emer te paditesve apo jo kete fakt nuk e kame vertetuar.

I demtuari nuk me ka paguar ne emer te pagE.s per AnKE., por ne emer te shpenzimevete meherhshme te veprimeve te mija juridike.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 05.12.2019, i akuzuari M.S, deklaron:personalisht konsideroj se në cilësinë e të autorizuarit të të paditurit këtu të dëmtuarit L.K, në kontestin civil nuk kam kryer vepër penale për të cilën akuzohem në këtë proedurë penale, me mos paarshtimin e ankesës në aktgjykimin e shkallës së parë të kësaj gjykate C.nr.78/2012 të datës 25.06.2013, kjo nga shkakau që edhe vet i dëmtuari është pajtuar me faktin që të mos parashtrroj ankesë në aktgjykimin e shkallës së parë, pasi që nuk ka pasur prova relevante me të cilat do të provohej e drejta e tij e pronësisë në paluajtshëmminë kontestuE. e cila ka qenë objekt i asaj procedure civile.

Pastaj nuk ndihem përgjegjës edhe nga fakti se unë si avokat gjegjësisht i autorizuar i këtu të dëmtuarit në pajtim me dispozitat e ligjit të procedurës civile që të mos parashtrroj ankesë në aktgjykime nëse vlerësoj se ankesa nuk do të ketë sukses gjegjësisht për shkak të ekonomizimit të procedurës civile.

Mirëpo edhe përkundër të cekurave më lartë, pas afatit prej 6 muajve prej datës të drejtës së paarshtimit të ankesës, i dëmtuari tek atëherë e ka shprehur qëllimin që kundër aktgjykimit kontestues të ndërmirn disa mjete juridike.Unë tek atëherë duke respektuar proozimin e të dëmtuarit, prokurorit të shtetit të Kosovës i kam parashtruar kërkesën për mbrojtje të ligjëshmëris, mirëpo prokurori i shtetit të Kosovës nuk e ka aprovuar lutjen time – kërkesën. Edhe përkundër kësaj unë në emër të dëmtuarit kam parashtruar kërkesë për mbrojtje të kushtetutëshmëris Gjykatës KushtetuE. të Kosovës, por Gjykata KushtetuE. e Kosovës, nuk e ka aprovuar kërkesën e paarshtuar.Gjithashtu edhe vet i dëmtuari gjithashtu ka deklaruar dhe ka parashtruar kërkesë për vlerësimin e kushtetutëshmëris Gjykatës KushtetuE. të Republikës së Kosovës të cilën kërkesë Gjykata KushtetuE. po ashtu e ka refuzuar.

Nga shkaqet e cekura konsideroj se edhe paarshtimi eventual i ankesës nuk do të aprovohej nga ana e shkallës së dytë.

Në procedurën civile C.nr.78/2012 gjykata ka bërë shikimin në vendin e ngjarjes me angazhimin e ekspertit të gjeodezis, mendimi i ekspertit të gjeodezis ka qenë që parcela kontestuE. ka qenë pronësi e paditësve në atë kontest, e që i padituri nuk ka poseduar prova bindëse që në çfardo baze të ketë qenë ndonjëherë pronar i parcelës kontestuE. që ka qenë edhe përfundim i gjykatës në bazë të së cilës edhe është marrë aktgjykimi dhe në të cilin ka qenë e bazuar sipas numrit dhe datës së lartëcekur.

Po kam pas autorizim nga ana e këtu të dëmtuarit në cilësinë e të paditurit në kontestsin civil C.nr.78/2012.Po kam pranuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Dragash dhe ate 78/2012. Me aktgjykimin e cekur po është aprovuar kërkesëpadia e paditësve. Me këtë aktgjykimin me përmbajtjesn e aktgjykimit mund të shikohet paragrafi 1 i aktgjykimit ku theksohet aprovohet kërkesëpadia e paditësve, derisa në paragarfin 2 të aktgjykimit të njëjtë kunër padia e kundërpaditësve – të paditurit L.K, kundër të paditurve familjes E. është refuzuar.

Është fakt jo kontestues që në cilësi të avokatit a kam paraqitur ankesë, jo nuk kam ushtruar ankesë. Nuk dëshiroj të përgjigjem në pyetjen se pse nuk kam parashtruar ankesë

Nuk më kujtohet data me siguri kam dhënë deklaratë pranë prokurorisë, jo nuk kam pasur kurfar presioni, deklaratën time e kam dhënë me dëshirën time të lirë të shprehjes, në proedurën që ka qenë fer nga ana e prokurorisë, pra pa presione.

Komform autorizimeve të avokatit sipas autorizimeve të autorizuarit në konstest civil, tërsia e asaj është që unë si mbrojtës pasi që kam vlerësuar me përmbajtjen e aktgjykimit të shkallës së parë dhe kam vendosur që të mos parashtoj ankesë, pasi që kam konsideruar se nuk do të ketë sukses në shkallën e dytë, kjo është e vërteta e tërë kësaj, konsideoj se kam vepruar komform ligjit. Kanë kaluar pesë apo gjashtë vite nga ajo kohë nuk më kujtohen detalet.

Unë e kam përpiluar në emër të këtu të dëmtuarit këtë kërkesë për Gjykatën Kushtetuese., por sa i përket ndonjë prove unë tërë dokumentacionin e kësaj lënde që e kam pasur në dispozicion i kam dorëzuar këtu të dëmtuarit në zyrën time. Sa i përket pranimit të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. si parashtrues i kërkesës pranë të njëjtës, sa më duket se po, por e tërë kjo i është dorëzuar të dëmtuarit.

I akuzuari M.S, në vazhdim të deklaratës së tij në mbrojtjen e vet deklaroi se nuk dëshiron të përgjigjet se pse nuk ka përdorur mjet tjetër juridik – kthimin në gjendjen e mëparshme. Konsideroj se edhe në konstestin civil në rastin konkret por edhe duke e shfrytëzuar nenin 90 të LPK, kam vepruar ashtu si në bazë të këtij neni. Sa i përket sipërfaqes kontestuese. ky fakt ka qenë jo kontestues, ka qenë 1 (një) arri dhe atë në kundërpasidhë në pajtim me atëherë të paditurin e kam precizuar të njëjtën

Nga këtu i dëmtuari në konstestin civil që e kam përfaqësuar kam pasur autorizim për ta përfaqësuar të njëjtin në cilësinë e të autorizuarit si avokat, kam pasur autorizim gjeneral. Kam pasur të gjitha të drejtat sipas bindjes sime për të ndërmarr në aspektin proedural dhe atë më lejoi neni 90 i LPK pra në rastin konkret kam konsideruar se ankesa në rastin konkret nuk do të kishte sukses andaj të njëjtën nuk e kam parashtruar

Nga provat e administruara dhe të cekura më lart, gjykata në mënyrë të plotë dhe të saktë e vërtetoi në tërësi gjendjen faktike dhe atë në bazë të deklaratës të dëmtuarit L.K dhe të dëshmitarëve A.K dhe A.K.2, të cilat deklarata në tërësinë e tyre janë identike sa i përket përmbajtjes së tyre ashtu që nga këto deklarata gjykata vërtetoi se nuk është kontestuese. që këtu i dëmtuari ka angazhuar për të autorizuar në çështjen civile këtu të akuzuarin i cili në këtë cilësi ka qenë i obliguar të mbroj interesat juridike të akuzuarit në cilësinë e të paditurit, në pasidhë e paditësve S., M. dhe H. E., para gjykatës themelore në Prizren – Dega në Dragash. Këto rrethana i pranon edhe i akuzuari në një pjesë të deklaratës së vet, por këtu i akuzuari në cilësinë e të autorizuarit të paditurit – këtu të dëmtuarit, nuk ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit gjykatës themelore në Prizren – Dega në Dragash. C.nr.78/2012 të datës 25.06.2013, i bërë i plotëfuqishëm me datë 04.07.2014, me të cilin aktgjykim paluajtshëria e pretenduar se është e tij në sipërfaqe prej 2.2 ari e locuar në parcelën kadastrale në vendin “... – ...”, me numër ..., e evidentuar në listën poseduese nr.133 ZK “...”, është bartur në emër të paditësve S., M. dhe H. E., të gjithë nga fshati ..., Komuna e Dragashit, dhe me këto veprime i akuzuari gjatë përfaqësimit për interesat pasurore të dëmtuarit, si i autorizuar – avokat i të paditurit, këtu të dëmtuarit L.K, nuk i përmbush detyrimet e tij si avokat i të njëjtit dhe nuk është kujdesur për interesat pasurore të këtu të dëmtuarit në cilësinë e të paditurit edhe pse i njëjti ka pasur autorizim nga i njëjti që ta përfaqësoj në kontestin civil kundër S.h E., etj, si dhe që si i autorizuar i tij mundet që në emër të tij dhe për llogari të tij të ndërmarr të gjitha veprimet juridike deri në përfundim të këtij kontesti si dhe të parashtoj propozime për ekzekutime të vendimeve gjyqësore dhe me këtë i ka shkaktuar dëm të dëmtuarit – të paditurit interesat pasurore të të cilit i ka përfaqësuar, duke mos parashtruar ankesë ndaj aktgjykimit C.nr.78/12 te dt. 25.06.2013, i plotëfuqishëm me dt. 04.07.2014, ashtu që edhe pse ka pranuar aktgjykimin e cekur me datë 11.06.2014, respektivisht me qëllim që seriozisht ti shkeli të drejtat e personit tjetër, të cilin fakt i dëmtuari e ka kuptuar kur ka kërkuar listë

poseduE. për pronën e vet pranë drejtorisë të kadastrit të kuvendit komunal në Dragash, gjykata në tërësi ju fali besimin, ngase sipas mendimit të gjykatës janë deklarata të besueshme dhe të pranueshme pasi që në përmbajtjen e tyre përputhen në mes veti dhe poashtu janë në përputhje edhe me provat materiale të cekura më lartë, të cilat prova pas vlerësimit dhe mendimit të gjykatës janë vendimtare në vërtetimin e gjendjes të plotë dhe të saktë të gjendjes faktike,

Këtyre deklaratave të dëmtuarit dhe dëshmitarëve të cekur, si dhe provave materiale

Aktgjykimi i plotfuqishem i Gjykares Themelore ne Prizren - Dega në Dragash P.br. 78/12 te dt. 25.06.2013, e plotfuqishme me dt. 04.07.2014,

Çertifikata e AKK-se - Njesia kadastrale ne Dragash P-.... të dhenat baze per Njesi te AKK-se me numer te lartpermendur te Zyres kadastrale te Komunes ne Dragash te dt. 29.04.2013

autorizimi i dhënë nga i dëmtuari L.K në cilësinë e të paditurit të dhënë me datë 29.06.2009, për përfaqësuesin e autorizuar av.M.S,

fletëdërgesa e Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Dragash, në gjuhën serbokroate P.nr.78/12 për pranimin e aktgjykimit të datës 25.06.2013 me të cilën konstatohet se i njëjti ka pranuar aktgjykimin e ekur me datë 11.06.2014,

raporti psikiatrik lidhur me mendimin psikiatrik për të dëmtuarin L.K të datës 27.08.2019,

në tërësi ju fali besimin, ngase sipas mendimit të gjykatës janë deklarata të besueshme dhe të pranueshme pasi që në përmbajtjen e tyre përputhen në mes veti dhe poashtu janë në përputhje edhe me provat materiale të cekura më lartë, të cilat prova pas vlerësimit dhe mendimit të gjykatës janë vendimtare në vërtetimin e gjendjes të plotë dhe të saktë të gjendjes faktike,

Me këto veprime i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barë, ngase duke vepruar si i autorizuar i të dëmtuarit në cilësinë e të paditurit nuk ka ndërrmar veprimet e domosdoshme që ka qenë si i autorizuar të ndërrmar, pra të parashtroj ankesë ndaj aktgjykimit të gjykatës themelore në Prizren – Dega në Dragash, dhe si i autorizuar është dashur ti mbroj interesat pasurore të dëmtuarit pasi që ka qenë i autorizuar nga i njëjri, andaj nuk i ka përmbushur detyrimet të cilat i janë besuar si i autorizuar, dhe nga kjo i ka shkaktuar dëm të dëmtuarit në cilësinë e të paditurit në dobi të paditësve, dhe me veprimet e përshkruara më lartë kryen veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, Andaj gjykata pas administrimit të provave të cekura më lart, analizimit dhe shqyrtimit të gjitha provave veç e veç dhe të gjitha së bashku, si dhe pas vlerësimit të të njëjtave nga të cekurat ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet qenësore dhe ate që i akuzuari gjatë përfaqësimit për interesat pasurore të dëmtuarit, si i autorizuar – avokat i të paditurit, këtu të dëmtuarit L.K, nuk i përmbush detyrimet e tij si avokat i të njëjtit dhe nuk është kujdesur për interesat pasurore të këtu të dëmtuarit në cilësinë e të paditurit edhe pse i njëjti ka pasur autorizim nga i njëjti që ta përfaqësoj në kontestin civil kundër S.h E., etj, dhe me këtë i ka shkaktuar dëm të dëmtuarit – të paditurit interesat pasurore të të cilit i ka përfaqësuar, duke mos parashtuar ankesë ndaj aktgjykimit C.nr.78/12 te dt. 25.06.2013, i plotfuqishëm me dt. 04.07.2014, ashtu që edhe pse ka pranuar aktgjykimin e cekur me datë

11.06.2014, respektivisht me qëllim që seriozisht ti shkeli të drejtat e personit tjetër, që si tërësi formojnë figurën e veprës penale dhe ate keqëpërdorimi i besimit nga neni 342 par.1 e lidhur me par.2 të KP-së, të përshkruar si në shqiptim të aktgjykimit dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, paraprakisht duke vërtetuar përgjegjësin e tij penalo juridike.

Sa i përket deklaratës të akuzuarit të dhënë në mbrojtjen e vet që aktgjykimin e gjykatës themelore në Prizren – dega në Dragash, C.nr.78/12 të datës 25.06.2013, e ka pranuar në hapësirat e gjykatës dhe se të njëjtin e ka futur me shkresat e një lënde tjetër të cilën lëndë në ditën e pranimit të aktgjykimit të cekur e ka përfaqësuar në gjykatë, si dhe aktgjykimin e ka lexuar vetëm sa i përket dispozitivit dhe sa i përket të njëjtit ka konsideruar që gjykata e cekur ka vepruar drejt dhe ka marr aktgjykim të drejt, kur ka shkuar në zyre aktgjykimin e cekur e ka vendosur me shkresat tjera dhe të njëjtin e ka kontrolluar pas 25-30 ditëve kur është paraqitur i dëmtuari në zyrën e tij, Poashtu i njëjti sipas bindjes ka menduar që edhe po qe se parashtrohet ankesa ndaj aktgjykimit të cekur e njëjta nuk do të ketë sukses, I akuzuari në vazhdim deklaroi se ka parashtruar duke respektuar proozimin e të dëmtuarit, prokurorit të shtetit të Kosovës i kam parashtruar kërkesën për mbrojtje të ligjëshmëris, mirëpo prokurori i shtetit të Kosovës nuk e ka aprovuar lutjen time – kërkesën. Edhe përkundër kësaj unë në emër të dëmtuarit kam parashtruar kërkesë për mbrojtje të kushtetutëshmëris Gjykatës KushtetuE. të Kosovës, por Gjykata KushtetuE. e Kosovës, nuk e ka aprovuar kërkesën e paarshtuar.Gjithashtu edhe vet i dëmtuari gjithashtu ka deklaruar dhe ka parashtruar kërkesë për vlerësimin e kushtetutëshmëris Gjykatës KushtetuE. të Republikës së Kosovës të cilën kërkesë Gjykata KushtetuE. po ashtu e ka refuzuar.

Kjo deklaratë sipas mendimit të gjykatës konsiston në drejtim të asaj që ka për qëllim shmangien nga përgjegjësia penale nga ana e të akuzuarit, ngase një deklaratë e tillë sa i përket përgjegjësisë penale të akuzuarit në mbrojtje e cekur më lart është tërësisht e pa bazë, e paqëndrueshme dhe kontrandiktore në tërësin e saj, e njëjta nuk është mbshtetur në asnjë provë konkrete dhe të qëndrueshme që do të mund të bind gjykatën që një deklaratë e tillë të ja fal besimin pasi që një mbrojtje e tillë është me qëllim si më lartë nga ana e të akuzuarit ku nga deklarata e të akuzuarit në mbrojtjen e tij i njëjti deklaroi se ka konsideruar se me ankesën e parashtruar eventualisht nuk do të kishte sukses në sshkallën e dytë në vazhdim deklaroi se nuk ka pasur prova të reja të ofruara nga këtu i dëmtuari – i padituri deklaratë kjo tepër kontradiktore edhe në bazë të deklaratës së tij gjykata konstatoi se një deklaratë e tillë në mbrojtjen e të akuzuarit si e tillë nuk mund të qëndroj nga arsyet e cekura më lartë.

I akuzuari ka theksuar se pranë kësaj gjykate është duke u zhvilluar tani proedura civile ku i dëmtuari tani në cilësinë e paditësit kundër të paditurve S.h E., etj, ku objekt i çështjes është e njëjta parcelë e cila ka qenë objekt kontesti edhe në procedurën civile ku këtu i dëmtuari ka qenë në cilësinë e të paditurit nga paditësi S.h E., etj, por gjykata në bazë të provave materiale dhe ate

padia e paditësit L.K, nga fshati ... të parashtruar me datë 08.05.2015,
aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren -Dega në Dragash për hudhje poshtë të padisë .nr.38/2015 të datës 14,07.2015, dhe
aktvendimi i Gjykatës të Apelit në Prishtinë A.nr.... të datës 23.01.2017, aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.16/2018 të datës 08.03.2018,

Nga të cilat prova të administruara vërtetohet se në rastin kur i akuzuari ka qenë i autorizuar i këtu të dëmtuarit - të paditurit proedura është zhvilluar që si objekt i çështjes ka qenë vërtetimi i pronësisë ndërsa në padin ku këtu i dëmtuari është në cilësinë e paditësit objekt i kontestit është për shkak të mbajtjes përkatësisht parashkrimit fitues, pra edhe përkundër asaj që palët janë të njëjta, parela e njëjtë si objekt i lëndës, kemi të bëjmë me proedurë tjetër të natyrës dhe llojit tjetër.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor administroi edhe provat tjera materiale kerkesa e te demtuarit L.Kper inicimin e procedures disiplinore Prokurorise disiplinore te OAK-se ndaj te akuzuarit M.Ste dt. 16.01.2015, Aktvendimi i Komisionit disiplinor te OAK-se ne Prishtine RDK nr. ... te dt.28.05.2015, me te cilin te akuzuarit M.Si u eshte shqiptuar masa disiplinore e gjobitjes ne shume prej 200,00 €. kerkesa per mbrojtjen e Ligjshmerise te parashtruar Prokurorise se shtetit te Kosoves ne Prishtine nga ana e te paditurit kunder paditesit L.Kte dt. 02.07.2014, lajmerimi i zyres se Kryeprokurorit te shtetit KMLC.nr. 70/14 te dt.05.08.2014, te parashtruar avokatit M.S. Vendimi i mosëprovueshëmrise të Gjykatës KushtetuE. sipas paarshtuesit L.K, me numër të rastit Ki.nr.59/15 të datës 06.04.2016;Aktvendimin e Gjykates Komunale ne Dragash C.nr. 80/06 te dt. 18.07.2006, çertifikata e Njesise kadastrale te Komunes se Dragashit me numer P-... te dt. 08.05.2015, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për krime të rënda P.br.196/2015 të datës 14.03.2016 i plotëfuqishëm me datë 01.08.2016, formulari i kërkesës në emër të L.K dhe aktvendimi i Gjykatës KushtetuE. me numër të rastit KI.nr.59/2015 të datës 15.03.2016, por pas vlerësimit të të njëjtave konstaton se provat e administruara si më lartë nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje penale

Gjykata shqyrtoi fjalën përfunimtare të mbrojtësit të akuzuarit, e cila fjalë përfundimtare sipas bindjes së gjykatës ishte në drejtim të shmangëjes të përgjegjësisë penale juridike të akuzuarit, por pa ofruar apo pa u mbshtetur në asnjë provë apo fakt me të cilat do të arsyetohej kërkesa për lirim nga akuza, apo mosekzistimi i elementeve të veprës penale ate keqëpërdorimi i besimit nga neni 342 par.1 e lidhur me par.2 të KP-së, vepër kjo e cila i vihet në barrë të akuzuarit,

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduE. e që si rrethanë lehtësuE. është marrë sjellja korrekte e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale, konform nenit 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuE. rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, është person familjar, baba i tre fëmijëve, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, moshë e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e saj pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro si dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuaro në afat të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoresh juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP-ës.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Dega në Dragash
P.nr.1/2019 me datë 27.01.2020

Procesmbajtësja
Kujtesa Uka

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankE. në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.